



## Pse duhet të shkojë fëmija juaj në qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijës?

### Çka janë qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijës?

Qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijës janë institucione parashkollore, që i ndihmojnë fëmijës suaj të ketë bazë të mirë për sukses të mëtejshëm në shkollë dhe në përgjithësi në jetë. Në qendër fëmija mëson përmes lojës, sipas programit të përshtatur ndaj moshës dhe interesave të tij. Qendra për zhvillim të hershëm të fëmijës është një vendi i sigurt në të cilin fëmija juaj mëson dhe luan me moshatarët e tij. Duke luajtur çdo ditë në qendër, fëmija juaj mund të mësojë shumë gjëra që do t'i ndihmojnë atij të ketë sukses në shkollë.

### Cili është vizioni jonë?

Të gjithë fëmijët janë të suksesshëm në shkollë nëse në fëmijërinë e hershme fillojnë të mësojnë në mënyra të ndryshme përmes lojës.

Loja në fëmijërinë e hershme është baza më e mirë për sukses në shkollë. Te fëmijët loja zhvillon shumë shkathtësi që janë të nevojshme për të lexuar, për të shkruar, për të menduar logjikisht, për të rrëfyer dhe për sjelljen e mirë me moshatarët dhe të moshuarit.

### Cili është misioni jonë?

T'u krijojmë të gjithë fëmijëve mundësi për mësim të hershëm në ambient që ofron shumë argëtim, me ç'rast do të njihet rëndësia e prindërve si mësuesit e tyre të parë dhe më të rëndësishëm.

### Pse duhet të shkojë fëmija në qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijës?

Fëmijët janë "të lindur për të mësuar", ndërsa në periudhën e pesë viteve të para ata mësojnë më së shumti dhe më së shpejti. Sa më herët që nxiten të mësojnë, aq më mirë do të jenë të përgatitur për në shkollë, por edhe për jetën në përgjithësi. Fëmijët që shkojnë në ndonjë institucion parashkollore mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë më shpejt dhe e përvetësojnë më lehtë programin e shkollës.

### Si do ta arrijnë atë në qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijës?

#### Përvoja e madhe

Programi i qendrës është koshient për nevojën e fëmijës për lojë, për lëvizje dhe për shoqërim. Programi do t'i mundësojë fëmijës suaj më shumë lloje të përvojave gjatë mësimin të hershëm dhe do t'i ndihmojë të mësojë dhe të zhvillohet në të gjitha fushat.

Mes tjerash, ai do të mësohet:

- të gjendet me fëmijët dhe të rriturit e tjerë
- të vizatojë, të ngjyrosë, të këndojë dhe të luajë
- të zbulojë dhe të zgjidhë probleme
- t'i fuqizojë aftësitë e tij verbale

- t’i shprehë nevojat e tij
- ta kontrollojë sjelljen e tij
- ta krijojë vetëbesim në vetvete
- të këmbëjë lodra që u përkasin të gjithë fëmijëve.

Me ne fëmija juaj do të mësojë më shumë për:

- Vetën e tij
- Për njerëzit e tjerë
- Për botën.

### Mësimi për sjelljen me të tjerët

Fëmija juaj do të mësojë si të gjendet me fëmijët e tjerë dhe:

- Të jetë i kujdesshëm dhe i dashur
- Të jetë pozitiv ndaj njerëzve të tjerë që janë të ndryshëm prej atij
- T’i shprehë ndjenjat e tij në mënyrë të drejtë
- T’u ndihmojë të tjerëve, por edhe të kërkojë ndihmë
- Të mësojë mënyra të mira të zgjidhjes së konflikteve
- Të punojë bashkërisht me të tjerët.

### Fëmija juaj është i veçantë

Edukatori i qendrës di t’i vlerësojë interesat dhe nevojat për mësimin e gjërave të reja te fëmija juaj dhe, në përputhje me këtë, t’i ndihmojë që gradualisht të përvetësojë shkathtësi të reja. Përmes fëmijës suaj edukatori do t’ju njoftojë juve dhe familjen tuaj, do ta kuptojë edhe kulturën tuaj dhe të komunitetit të cilit i përkisni. Fëmija juaj do të shihet si një person i veçantë, e jo vetëm si “njëri nga fëmijët e shumtë”

### Mbështetja për prindërit

Ju do të keni mundësi të bisedoni me edukatorin dhe ta merrni mbështetjen e nevojshme për cilëndo brengë që e keni rreth fëmijës suaj. Fëmija juaj do të përparojë më shpejt nëse i tregoni personelit se çfarë dëshironi dhe nëse, me ndihmën tuaj, ata arrijnë t’i njohin më lehtë tiparet dhe nevojat e tij. Ju do të keni mundësi t’i njoftoni edhe prindërit e tjerë dhe bashkërisht të merrni pjesë në aktivitetet e qendrës.

Qendra do t’ju ndihmojë nëse keni nevojë për ndonjë lloj tjetër të ndihmës për fëmijën tuaj, për ju ose për familjen tuaj.

### Pikëpamjet për të ardhmen

Fëmija juaj ka nevojë për ndihmë që t’i përvetësojë sot shkathtësitë e nevojshme për të, që pastaj ta ketë më lehtë në të ardhmen – në shkollë, në vendin e punës dhe, në përgjithësi, në jetë. Fëmijët që janë të sigurt në vete dhe që ndjehen se janë të dashur, janë:

- Shumë më të lumtur, më të motivuar, më kureshtarë
- Më të qëndrueshëm, më të pavarur, por edhe të hapur për bashkëpunim
- Të aftë që të krijojnë dhe të mbajnë miq
- Të aftë që të ballafaqohen me situata të stresit
- Të aftë që ta zgjedhin drejtimin e duhur dhe të ndjekin rregulla të dobishme
- Të aftë që shumë më lehtë të gjenden në çfarëdo situatash.

Qendra për zhvillim të hershëm të fëmijës i ndihmon familjes suaj dhe ia krijon fillimin më të mirë fëmijë suaj!!!

Urdhëroni, na vizitoni dhe pasurojeni shoqërinë tonë edhe me një anëtar – regjistroni fëmijën tuaj!